



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PA1.nr.1030/22

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Beqir Kalludra, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me praktikanten gjyqesore Blerta Thaçi si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.S. nga fshati ....., k. e Obiliqit, për shkak të veprës penale shfrytëzimi pa posedim të licensës nga KPMM nga neni 80 i Ligjit për Miniera dhe Minirale, e në bashkim real me veprën penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par. 3 i KPRK-së, si dhe për veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 të KPRK-se, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtri P.nr.412/21 të datës 06.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23 janar 2023 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtri P.nr.412/21 të datës 06.06.2022, **VËRTETOHET**.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtri P.nr.412/21 të datës 06.06.2022, ndaj të akuzuarit B.S., konform nenit 363 paragrafi 1 pika 1.3 të KPPRK-se, është refuzuar akuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale për shkak të veprës penale të rikualifikuar nga Gjykata Shfrytëzimi pa posedim të licensës nga KPMM nga neni 80 i Ligjit për Miniera dhe Minirale. Konform nenit 364 par.1 pika 1.4 të KPPRK-së është liruar nga akuza në mungesë të provave për shkak të vepës penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par. 3 i KPRK-së. Kuptim të nenin 363 par 1 pika 3 të KPPRK-së është refuzuar akuza për shkak të parashkrimit absolut për shkak të veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 të KPRK-se .

Shpenzimet e procedurës penale i janë lënë në barrë mjeteve buxhetore të gjykatës.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

## **Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjegje në ankesë ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit B.S.- av. Irfan Zushi nga Vushtrria i cili ka propozuar që ankesa e prokurorisë themelore në Mitrovicë të refuzohet si pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shjarruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë me shkresën e vet PPA.II.nr.1068/22 të datës 17.08.2022 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë ta aprovoje si të bazuar, te anulohet aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë dhe çështja të kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe gjeti se:

### **- Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës të njëjtin e shqyrtoi në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Sa i përket bazës ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike kur ka konstatuar se nuk ka prova të mjaftueshme që i akuzuari B.S. të ketë kryer veprën penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par. 3 i KPRK-së. Sipas Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë provat e prezantuara nga ana e prokurorisë, dhe e njëjta referohet në deklaratat e dëshmitarëve- inspektorëve të KPMM-së të cilët mes tjerash kanë deklaruar se në vendin e ngjarjes nuk e kanë takuar askënd se nuk e njohin të pandehurin dhe se kallximi penal është shkruar sipas urdhërit të ish kryeinspektorit dhe se nuk ishte i mundur vërtetimi se sa ishte dëmi i shkaktuar. Megjithatë Prokuroria pretendon se Gjykata e shkallës së parë rikualifikimin e veprës penale nga vjedhja e rëndë nga neni 327 par 1 të KPRK-s sic ka qenë i akuzuar e ka rikualifikuar në bazë të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike në veprën penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par. 3 i KPRK-së e pastaj ka nxjerrë aktgjykim lirues e sikur të njëjtat të ishin vlerësuar në mënyrë të duhur i akuzuari është dashur që të shpallet fajtor për veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së për të cilën është akuzuar, e ku si pasoje e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike gjykata e shkallës së parë sipas prokurorisë në rastin konkret

e ka shkelur ligjin penal ne favor te akuzuarit kur ka bërë ricilsimin juridik të veprës penale dhe pastaj të njëjtin e ka liruar nga akuza.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjeti se pretendimet e tilla nuk janë të bazuara. Sipas kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se nuk ka prova të mjaftueshme që i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor para gjykates se shkalles se pare, respektivisht degjimit te dëshmitarit R.M. dhe R.M1. inspektor të dëmtuarës KPMM, si dhe provave materiale, ka vërtetuar se në vendin e ngjarjes dëshmitarë nuk e kanë pa askënd dhe nuk e kanë hasur as më herët e gjithashtu edhe i pandehuri B.S. ka deklaruar se përkundër se kish të pasur për qëllim që të njerrë qymyr punën e kishte ndërprer menjëherë pas paralajmërimit të inspektorëve dhe se nuk është e vërtetë se ai ka nxjerrë qymyr. Nga këto Gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të vërtetojë se i pandehuri B.S. ka shfytëzuar ilegalisht resursin mineral- Thëngjillin për qka edhe e ka liruar në mungesë të provave nga akuza.

Gjendjen e tille te vertetuar faktike nga ana e Gjykatës së shkallës së parë e aprovon edhe Gjykata e Apelit si te drejte dhe te ligjshme, duke i refuzuar si te pabazuara pretendimet ankimore te Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë, lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike.

Sipas Gjykates se Apelit, gjykata e shkalles se pare ne rastin konkret kur te akuzuarit i ka liruar nga akuza drejte e ka aplikuar edhe ligjin penal, andaj edhe pretendimet ankimore te Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë lidhur me shkeljen e ligjit penal i refuzoi si te pabazuara.

Lidhur me dy veprat tjera penale për të cilat është refuzuar akuza për të njëjtat ka rrjedhur parashkrimi absolut.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1030/22 më 23.01.2023**

**Procesmbajtëse**  
**Blerta Thaçi**

---

**Anëtarët e kolegjit**  
**Abdullah Ahmeti**

---

**Kryetar i kolegjit,**  
**Beqir Kalludra**

---

**Zyhdi Haziri**

---